



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kacanik  
Municipal of Kacanik

01Nr. 060/01-21329/24  
Kaçanik, 17.09.2024

## PROCESVERBAL

Nga Diskutimi publik me qytetarë, administratorë të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, OJQ, përfaqësues të shkollave dhe grupe tjera të interesit, organizuar nga Kryesuesi i KK në konsultim me Komitetin për Politikë dhe Financa-KPF.

Diskutimi publik u mbajt me 17 shtator 2024 në katin III në sallën e KK, me fillim pune në ora 11:00.

Evidenca e pjesëmarrësve është si në listën e bashkëngjitur (përfaqësues nga OJQ, grupe tjera të interesit, administratorë të fshatrave, anëtarë të KK, anëtarë nga ekzekutivi i komunës).

Diskutimin publik e kryesoj, Kemal Murseli-Kryesues i Kuvendit,

Procesmbajtëse: Makfire Malsiu, Zyrtare e Lartë për Punë të Kuvendit të Komunës

**Tema: Propozim Buxheti për vitin fiskal 2025 dhe vlerësimet për vitet 2026-2027.**

**Kryesuesi i Kuvendit - Kemal Murseli-** Fillimisht i njoftoj pjesëmarrësit për aktivitetin e Ekzekutivit të komunës në mbajtjen e dëgjimeve publike për buxhetin, drafti na është përcjellë, ashtu si e përcakton LVL. Gjatë kësaj periudhe është në obligim ligjor organizimi dhe mbajtja e dëgjimit publik e Kryesuesit të KK në bashkëpunim me KPF para se të dalë drafti në KK. Ligji e përcakton qartë që qytetarët bëhen pjesë e vendimmarrjes në dëgjime publike para miratimit final në KK. Buxheti i vitit 2024 është 12,592,239.00€. Shpenzimet buxhetore janë të ndara në 5 shtylla: Paga dhe Mëditje, Mallra dhe Shërbime, Shërbime Komunale; Subvencione dhe Transfere, Investime Kapitale. Për sqarime me të hollësishme mund të na japin, Kryetari i Komunës-Besim Ilazi dhe Drejtori për Buxhet dhe Financa-Bahri Selimi.

**Kryetari i Komunës- Besim Ilazi:** Ky është diskutimi i fundit i buxhetit. Buxheti i vitit 2025 është: 12,592,239.00€. Ne si ekzekutiv me të gjitha drejtoritë, kemi mbajtur debate të ndryshme për buxhetin, me të gjitha kategoritë, qytetarët, OJQ, këshillat me të mëdha të fshatrave, shëndetësinë, dhe grupet tjera të interesit, jemi munduar me i inkorporuar kërkesat për ndarje buxhetore. Në listën e prioritete është bërë orientimi i tyre, nuk d.m.th. që nuk ndryshon deri me 30.09.2024. Krahasuar me buxhetin 2024, kemi rritje të buxhetit për të IK për 310,000€.Sqarimet i jep me në detaje drejtori i DBF. Kërkoj nga ju t'i jepni kërkesat për orientime e juaja të projekteve, në përputhje me buxhetin. Kërkesat janë të gjitha të arsyeshme, por ne do të mundohem me iu dhënë prioritet atyre me të nevojshme.

**Drejtori i DBF- Bahri Selimi:** Sqaroj për buxhetin e projektuar për vitin 2025 dhe vlerësimet për vitet 2026-2027 dhe diskutimet publike të mbajtura nga ekzekutivi i komunës. Buxhetin e kemi në kornizat finale. Buxheti i vitit 2025 është 12,592,239.00€.



kemi ngritjen me të madhe të IK për 310,000€ %. Për Investime Kapitale (IK) i kemi nda 3,475,583€€, kemi ngritur IK duke pa kërkesat e juaja të arsyeshme në dëgjime publike. Shpërndarja buxhetore është si vijon: Paga dhe Mëditje,6,865,266.00€, Mallra dhe Shërbime,1,514,233€, ShërbimeKomunale,225,000€,Subvencione dhe Transfere, 514,157.00€. Listën e projekteve kapitale të planifikuara për vitin 2025, drafti na përcjellët neve me ndonjë ndryshim dhe finalizohet për KK, kështu që shfrytëzoni këtë rast për diskutim.

**Kryesuesi i Kuvendit-Kemal Murseli:** Buxheti është ky që është propozuar, kërkesat mund të përshihen aq sa mund të kalkulohen me këtë buxhet, se ky buxhet nuk mund të rritet as të zvogëlohet. I dëgjuat sqarimet e ekzekutivit të komunës, e hapi debatin: fillimisht para se me marrë fjalën, prezantoheni secili.

**z. Artan Guri:** Kërkoj të hyn në buxhet, rruga “Nerimane Guri”, për asfaltimin e saj, rrugë kjo mbi 500 metra gjatësi. Ne kemi intervenuar edhe vet në atë rrugë në zhavorr, por kur po ka të reshura atmosferike, po priset. Kërkoj të shqyrtohen mundësitë që komuna me bërë asfaltimin e asaj rruge se është nevojë, ka shtëpi aty, ara e livadhe.

**Kryetari i Komunës- Besim Ilazi:** Në vitin e kaluar e kemi përmbyllur një pjesë bukur të madhe të rrugëve dhe rrugicave në atë pjesë, a kanë qenë të qëlluara, kërkesat na vinë prej administratorëve të fshatrave, dhe ne duhet të respektojmë vullnetin e administratorëve, të cilët i keni përzgjedhur ju vet. Besoj se edhe asaj rruge do t'i vjen radha, por nuk mundem të themi sivjet apo vitin vijues, se buxhetin e kemi të kufizuar, me atë buxhet po mundohemi me përshtirë prioritetet e fshatrave. Sa i përket dritave, ne i kemi bërë në rrugët kryesore, ndërkaq nëpër lagje i kanë bërë vet, ne i kemi me i mirëmbajtur. Po mundohem me u kujdesur se ku është ajo rrugë, kur do të realizojmë, nuk kam përgjigje sot, se jemi në fund të vitit dhe buxheti për rrugë lokale dhe rurale është në përfundim e sipër, duhet me menduar për vitin vijues për këtë rrugë.

**z. Zijadin Zenuni: Operator NT-“Duraj Trans”:** Unë e bëjë bartje e nxënësve përmes linjave: Semajë-Kaçanik, Semajë –Elezaj dhe Sllatinë-Doganaj. Në vitin e kaluar kur është tenderuar transporti, me është caktuar një shumë e ulët e mjeteve, në raport me vijat tjera. Sa ka me qenë buxheti sivjet, duke pasur parasysh rënien e numrit të nxënësve për këto vija transporti.

**Kryesuesi i Kuvendit-Kemal Murseli:** Drejtori i arsimit nuk është këtu, informatat mund t'i merrni me të sakët në Zyrën e drejtorit të DA, se numri i nxënësve ka ra në këtë vit, drejtori i bënë planifikimin e numrit të nxënësve për vija të transportit. Drejtori besoj se e ka bërë planifikimin të kategoria e subvencioneve dhe mundeni me saktë me i marrë të dhënat.

**z. Brahim Dalloshi-Administrator i f. Soponicë:**

1. Ne kemi pasur kërkesë për një fushë sporti, kërkesa është adresuar para 2 viteve, nuk ka asgjë në këtë drejtim;
2. Kërkesë për ndërtimin e një Çerdhe për fëmijë të komunitetit Soponicë;
3. Lokacioni për varreza, kjo çështje është vendosur në KK, por ne nuk jemi ende të sigurt për atë lokacion që është vendosur;
4. Kërkesë për ndërtimin e një Parku në fshat.

**Kryesuesi i Kuvendit-Kemal Murseli:** Kërkesa për lokacion për varreza është shumë e arsyeshme. Ne kemi vendosur në KK për lokacion për varreza në bazë të komunitetit dhe BI, por çështja është se MAPL na e ka kthyer prapa vendimin, se nuk ka qenë me PZHK



të vitit 2010. Me PZHK të ri, është paraparë lokacioni për varreza, por çështja është se vendimi nuk ka pasur mundësi me hyrë në fuqi, se është kthyer nga MAPL, se nuk është në harmoni me PZHK e vitit 2010. Ne po presim miratimin e PZHK të ri, ku në këtë plan është lokacioni për varreza. Nevoja është urgjente, se vendi është mbushur, deri sa të hynë në fuqi PZHK i ri, duhet organizojmë ndonjë takim me komunitetin dhe të bëjmë ndonjë zgjidhje të lokacionit për varreza. Kërkesat tjera janë sipas mundësive buxhetore që i parashohin drejtoritë.

**Kryetari i Komunës- Besim Ilazi:** Sa i përket terreneve sportive, kemi punuar në këtë drejtim, është bërë fusha sportive në Gllloboçicë. Besoj se i vjen rendi edhe në komunitetin e f. Soponicë. Të çështja e çerdheve për fëmijë, ne kemi marrë premtim prej qeverisë, për 2 çerdhe, në Kaçanik të Vjetër dhe në Rekë. Si komunë i kemi përmbushur kriteret me dokumentacion, me lokacione jemi në rregull me dokumente, po shpresojmë të realizohen premtimet nga niveli qendror. Sa i përket parqeve, ne kemi filluar me ndërtimin e tre parqeve, në Kaçanik të Vjetër, Hajdaraj, ndërkaq shumë shpejt do të vjen rendi edhe në komunitetin Soponicë. Sa i përket varrezave, e theksoj edhe kryesuesi, çështja është të PZHK.

**z. Zijadin Zenuni: Operator NT-“Duraj Trans”:** Pse nuk janë tenderuar subvencionimi i transportit, 2024/2025, sidomos vijat që i mbajë unë. Semajë –Ferizaj, Sllatinë-Doganaj.

**Kryesuesi i Kuvendit-Kemal Murseli:** Unë e potencova që drejtori nuk është këtu për ndonjë përgjigje, se ne nuk e dimë. Mund të shikoni për këtë çështje edhe të Zyra e prokurimit, por duhet pasur parasysh se po flasim për buxhetin 2025 dhe projeksionet 2026-2027.

**z. Fadil Vishi: Administrator i f. Dubravë:** 1. Është mirë që në buxhet kishte hyrë si kod, projekti, Ndërtimi i një fabrike të ujit, pasi f. Dubravë, ka pasur shumë probleme me ujin e pijes, ndërkaq duhet me i dhënë shtytje për realizim.

2. Rregullimi i përroskave, nëse ka mundësi diçka në këtë drejtim,

3. Furnizimi i shkollës së Dubravës me perde,

4. Furnizimi i popullatës me lëndë djegëse-dru;

5. Shtrimin me zhavorr të rrugës. Shtëpia e Shumarëve-Lyboten.

6. Ndarja e një prone për varreza. Është një pronë e propozuar, por ishte në emër të Agjencisë së pyjeve. Kërkesën ia kemi bërë agjencisë, por nuk na ka kthyer përgjigje. Vendi është i mirë, i mjaftueshëm, nuk e di sa keni mundësi me ndikuar si autoritet në agjencion.

**Kryetari i Komunës- Besim Ilazi:** Sa i përket perdeve në shkolla, kërkesat drejtorët e shkollave ia bëjnë drejtorit të DA. Është kodi për mirëmbajtje dhe renovim të shkollave. Kjo është çështje e vogël, dhe nuk paraqet problem. Të lëndët djegëse, Pylltaria ka kaluar në agjencion. Tani nuk e kemi në kompetencë, megjithëse nuk e kemi pasur asnjëherë. Me adresuar një kërkesë si autoritet, nuk na pengon që me iu shërbyer qytetarëve për lëndë djegëse. Sa i përket rrugës, është e nevojshme me u shtruar ajo rrugë, megjithëse është në parkun nacional, kemi menduar që ministria me bërë një zgjidhje urgjente, por nuk ka diçka në këtë drejtim. Jemi duke e shqyrtuar mundësinë me mirëmbajtur se paku me zhavorr atë rrugë, se ne nuk kemi mundësi tjera buxhetore. Të çështja e lokacionit për varreza, po interesohemi qysh është forma me ia bërë një kërkesë agjencisë, për me bërë shpronësimin e asaj pjese.

**z. Fadil Vishi: Administrator i f. Dubravë:** Të çështja e derivateve-dru të komunës tonë, iu kanë dhënë dru, por jo të pjesa e parkut, diku gati në Gllloboçicë. Unë kam biseduar me



Agimin, është terren shumë i papërshtatshëm që nuk ka mundësi me u nxjerrë ato dru, kështu komuniteti i Dubravës nuk ka mundësi me u furnizuar me ato dru. Me pas fol me ata të agjencisë që me u furnizuar diku kah pishat të Strazha.

**Kryetari i Komunës- Besim Ilazi:** Kemi bashkëpunim të mirë me ata të agjencionit, kemi me bashkëbiseduar këtë çështje.

**z. Hasip Salihu: Administratorë i f. Bajnicë:** I kam tre kërkesa të arsyeshme:  
1. Ndërtimin e rrugës : Semajë-Gaçkë, rrugë kjo që ia shkurton distancën komunitetit, me bërë një intervenim të kësaj rruge, fillimisht me zhavorr.

2. Vazhdimi i rregullimit të përroskës në Bajnicë, pasi si rezultat i përroskës po rrezikohet uji i pijes, se në afërsi të ujit ka mbetur pa u kryer, janë diku 70-80 metra. Kam biseduar për këtë çështje edhe me drejtorin. Është mirë ky projekt të hyn në prioritet, që mos të rrezikohet uji i pijes.

3. Shtrimin e disa rrugicave në fshatin Bajnicë.

**z. Zijadin Zenuni: Operator NT-“Duraj Trans”:** Subvencionimi për transportin e nxënësve është në shumë të vogël. A ka mundësi me u rritur subvencione, duke marrë parasysh konfiguracionin e vendeve kah e mbajë unë transportin E përmendi edhe kryetari se janë ngritur subvencionet diku 100, 000€.

Kërkoj me intervenuar në disa pjesë të rrugës, në f. Sllatinë, se është një humnerë, edhe në f. Semajë të Epërme, në pjesën me të madhe ku unë e bëjë kthimin, është një humnerë në anën e poshtme, pa kurrfarë mbrojtëse. Nëse e keni vëzhguar terrenin e dini ku janë. Unë mendoj se pagesa në këto rrugë duhet me qenë pak me e lartë, sepse shuma e mjeteve është simbolike e subvencioneve.

**Kryesuesi i Kuvendit-Kemal Murseli:** Janë kushtet dhe kriteret që përcaktojnë subvencionet, ato janë unike për krejt vendin në bazë të rregullave ligjore për km. në orë të transportit. Është një komision që e vlerëson, të nxënësit është diku mbi 4km. largësi, me i subvencionuar. Besoj se është formula që e cakton çmimin për nxënës, por mos të kapemi në këto tema, pasi nuk është drejtori këtu. Sqarimet mundesh me i marrë të drejtorit. Të çështja e rrugëve, aty ku është e domosdoshme me intervenuar, se është terreni me i vështirë, DSHPE e ka për obligim me dal në vendngjarje, me shikuar gjendjen, ashtu që me intervenuar aty ku ka nevojë.

**z. Azem Koraqi Administrator i f. Kovaçec:** Kërkoj të bëhet shtimi i pengesave në rrugë, se janë vendosur do pengesa, por ka nevojë ende. Kemi pasur kërkesë për këtë çështje, por ende nuk është marrë ndonjë veprim. Është një pjesë të nënkalimi i autostradës, në dalje, deri aty është trotuari, është shumë keq aty, edhe pse është shpronësuar, por nuk ka dëgjuar me lëshuar pronën. Është duvari dhe kthesë dhe nuk shihet asgjë, gjë që paraqet rrezik për fëmijë. Është mirë me intervenuar në atë pjesë sa nuk ka ndodhur ndonjë fatkeqësi, pasi është shpronësuar ajo pjesë, apo me vendosur ndonjë pengesë se automjetet lëvizin shpejtë dhe rruga është e padukshme.

**Kryetari i Komunës- Besim Ilazi:** Nuk po e di vendin saktësisht. Sa i përket pengesave, ne e kemi një inspektor, në bashkëpunim me policinë po mundohemi me vendosur në bazë të kërkesave të komunitetit, me vendosur pengesa sa me pak në asfalt, se veç po bëhen gunga në rruga. Qëllimi ynë dhe i juaji është me u vetëdijesuar qytetarët me pasur kujdes, se është duke rrezikuar fëmijën e vet. Të gjithë ata që marrin patentë shofer i dinë rregullat e komunikacionit, nuk duhet me na ardhur keq me lajmëruar policinë, se nëse vendosën



shumë pengesa, janë problem me dërguar të sëmurin në ambulancë. Për mua është me e arsyeshme me bërë vetëdijesim të qytetarët, për mos me rrezikuar jetën e askujt, përndryshe ne kemi vendosur shumë pengesa, por çështja është si me i hequr ato pengesa.

**z. Azem Koraqi\_Administrator i f. Kovaçec:** Është nevojë në atë vend për me vendosur pengesa ende, mund të dilni në terren kushdo dhe e vlerësoni gjendjen. Nëse e vlerësoni se nuk ka nevojë, unë jam i pajtimit, por çështja është se automjetet lëvizin shumë shpejt dhe nga duvari nuk shihet asgjë në atë pjesë, fëmijët dalin drejt prej trotuarit në rrugë dhe mund të rrezikohen, se nuk shihet asgjë aty.

**Kryetari i Komunës- Besim Ilazi:** Sot pasdite kemi me dërguar inspektorin e komunikacionit, Besim Sallahu, me parë gjendjen. Qëllimi ynë është me i zvogëluar pengesat, me u vetëdijesuar vozitësit e automjeteve.

**z. Rrustem Zenuni:** Paraqiti këto kërkesa:

- 1 Ndërtimi i terreneve sportive ne fshatin Duraj dhe Gabrricë.
- 2 Rregullimi i hapësirave publike edhe një parku ne fshatin Duraj dhe Gabrricë në rrugën "Hetem Hasaj".
- 3 Asfaltimi i rrugës "Razim Hasaj".
- 4 Asfaltimi i rrugës alternative në fshatin Duraj dhe Gabrricë.
- 5 Vazhdimi i trotuarit ne rrugën "Hetem Hasaj" në drejtim te fshatit Bajnicë.
- 6.Asfaltimi i rrugicave ne fshatin Gerliëcë e Epërme.

**z. Zijadin Osmani-ShF "Nazmi Osmani:** 1. Kërkesa ime është për mirëmbajtjen e pajisjeve teknologjike në shkollë, kërkesa është drejtuar edhe me herët në komunë.

2. Mirëmbajtjen e kamerave. Kamerat për momentin nuk funksionojnë, si fotokopjues etj.  
3. Rrjeti i shkollës së vjetër është me postën, ndërsa në shkollën e Bajnicës nuk ka operator që ka kontratë me komunë. Në f. Bajnicë operon dikush tjetër. Deri tani e kemi paguar në formë private, konkretisht f. Koxhaj na kanë paguar rrjetin atje. Nuk po dimë kujt me iu drejtuar me këto kërkesa, besoj se i merrni parasysh këto çështje, që me i rregulluar.

**z. Fadil Vishi: Administrator i f. Dubravë:** Të çështja e pengesave në rrugë, unë jam kundër pengesave aty ku ka trotuare. Në Dubravë dje ishte vendosur një pengesë në rrugë, por çështja është se është dashur të vendoset sa me afër shkollës, në mënyrë që mos me vendosur pengesa tjera, se kjo po ndikon keq të qytetarët dhe po krijon mundësinë për kërkesa tjera. Të mirëmbajtja e kamerave, edhe në shkollën e Dubravës, kamerat nuk funksionojnë, kamerat nuk i mirëmban askush.

**Kryetari i Komunës- Besim Ilazi:** Për çështjen e kamerave, ka 5-6 muaj që iu kam thënë me adresuar kërkesa se janë edhe 3-4 kamera edhe në qytet. Duhet me u adresuar të gjitha kërkesat në mënyrë që të shpallet tenderi për mirëmbajtjen e tyre, për me zgjedhë operatorin për mirëmbajtjen e tyre, se mundësi tjetër nuk kemi.

**z. Ramadush Osmani-DSHPE:** E jap një sqarim rreth vendosjes se barrierave. Është komisioni komunal, inxhinieri i komunikacionit përgjegjës, i cili i shqyrton kërkesat për barriera në rrugë të caktuara. Ky komision e shqyrton edhe anën profesionale, është një kriter se qysh vendosen barrierat dhe cilat kushte duhet me i plotësuar. Në rrugën e Kovaçecit nga shkolla deri të rruga ku e potencoj administratori i fshatit, janë diku 5



barriera në një gjatësi të rrugës me pak se 1 km. Tani me vendosur ende barriera në atë pjesë, është shumë.

**z. Azem Koraqi \_Administrator i f. Kovaçec:** Çështja është se në atë pjesë është vendi jo i dukshëm, paraqet rrezik për qytetarë nga ngasja e veturave.

**z. Ramadush Osmani-DSHPE:** Inxhinieri është i asaj pjese dhe del e vlerëson gjendjen.

**z. Bislim Krasniqi-Drejtor i SHFMU “Qamil Ilazi” Kaçanik të Vjetër:** 1. Ne kemi çështjen e rrethojës së shkollës, ku për shkak të ndryshimeve kadastrale që janë bërë, duhet shkuar një pjesë prapa shkollës. Kërkoj të shqyrtohen mundësitë me futur në prioritet me buxhet.

2. Mungesa e kabinetit të informatikës në shkollë. Shkolla i ka marrë donacion nja 10 kompjuterë nga Caritasi, por shkolla nuk ka kabinet.

3. E përkrahi drejtorin e shkollës Elezaj, i cili e ngriti çështjen e mirëmbajtjes së pajisjeve teknologjike, fotokopjues nuk kemi, por për printerë, se është nevojë mirëmbajtja edhe në shkollën në Kaçanik të Vjetër, se nevojat janë shumë të mëdha për pajisje teknologjike, se duhet fotokopjohen programet javore, mujore etj.

**z. Zijadin Zenuni: Operator NT-“Duraj Trans”:** Në një takim me z. Ramadush Osmani e ka përmendur me i subvencionuar itineraret. Kërkoj nga drejtori me bërë një kërkesë që këto kompani që operojnë në Bajnicë dhe Begracë, ( firma Endriti), me paguar peronizim. Kjo ndikon në shtimin e buxhetit të komunës. E dyta, rruga e “UÇK’-së është në gjendje të mjerueshme, ka nevojë për intervenime. Të turizmi, unë dërgoj turistë në gjithë Kosovën, ndërsa nuk e shoh se vjen kush në Kaçanik në vizitë turistike. Ku qëndron problemi që askush neve nuk na viziton. Në komunën tonë kemi monumente historike, por nuk kemi vizita, p.sh. në formë të organizuar qysh i dërgojmë në nxënësit në vizita në krejt Kosovën, me ndonjë marrëveshje në mes të komunave.

**Kryesuesi i Kuvendit-Kemal Murseli:** Është çështje e secilit kënd donë me vizituar. Edhe ne nuk i dërgojmë nxënësit në krejt komunat në Kosovë, p.sh. në vende të vogla, nuk i dërgojmë. Prioritet duhet me i kushtuar në turizmit, se kemi bjeshkë të mrekullueshme që munden me qenë atraktive për turistë, ndërkaq e di se i vizitojnë bjeshkët tona jo vetëm nga Kosova, por edhe me gjerë. Komuna i ka kushtuar rëndësi turizmit, ndërtimi i shkallëve të Guri i Shpumë, stazat në f. Strazhë. Duhet marrë veprime në të ardhmen edhe për vende tjera turistike, ndërkaq sa na vizitojnë, nuk varën nga ne. Obligimi jonë është me ofruar mundësi dhe kushte për ata që duan me na vizituar, ndërkaq ne e dimë që pritshmeritë janë me të vogla në vendet e vogla.

**Kryetari i Komunës- Besim Ilazi:** Ne nuk mundemi me ia imponuar askujt kënd me vizituar, ajo është në bazë të dëshirës dhe vullnetit të tyre. Pajtohem se përfiton komuna të hyra, por nuk mundemi me ia imponuar askujt, ndërkaq ne duhet me krijuar kushte turistike për vizitorë, se kjo na takon si komunë.

**z. Brahim Dalloshi-Administrator i f. Sopicë:** Sa i përket vizitave turistike, në Strazhë dhe në Lyboten ka turistë, jo vetëm nga Kaçaniku por edhe me gjerë, se unë po i shoh se shkojnë me autobusë.

**znj. Pranvera Loku-Zharku-DAP:** E njoftoj z. Zenuni se kohëve të fundit janë ngritur për 30% numri i turistëve në f. Strazhë, për shkak të investimeve të komunës që janë bërë aty. Kemi turistë në formë të organizuar nga shkollat, forcat e KFORI-it nga Maqedonia e Veriut dhe nga vendet tjera. Nuk është e vërtetë se nuk ka vizitorë nga vendet tjera, se



është pikërisht fshati Strazhë që vizitohet shumë nga turistë të huaj dhe qytetet tjera të Kosovës.

**z. Zijadin Zenuni: Operator NT-“Duraj Trans”:** Unë po themi me u vizitua Kaçaniku, se ka histori të bujshme, si shpalla e Kushtetutës së Kaçanikut, kështu mundet në formë të organizuar me u vizituar nga nxënësit e shkollave të komunave tjera. Kompanitë që vijnë prej Ferizajt, pse mos me paguar peronizim. Nuk me dha përgjigje drejtori i DSHPE për peronizim dhe nuk mora përgjigje për rrugën e “UÇK-së”.

**Kryesuesi i Kuvendit-Kemal Murseli:** Rruga e “UÇK-së” është me buxhet në vitin e ardhshëm me u shtruar. Presim mjete prej qeverisë, se është rrugë kryesore.

**z. Ramadush Osmani-DSHPE:** Janë do rregullore, peronizimi është në stacion. Kur futesh në stacion, paguan peron, jashtë peronit, që po thoni në f. Bajnicë etj. nuk paguan peron. Subvencionimi i rrendeve të udhëtimit, në këtë mbledhje të KK, është Plani i transportit për 5 vjet. Drejtorja harton planin 5 vjeçar dhe i qet traqet. Nëse ne duam me pas një vijë p.sh. për Kotlinë, askush nuk shkon atje, por ne nëse duam me mbajtur atë vijë, duhet me subvencionuar.. Plani është 5 vjeçare, drejtorja i propozon traqet, i ka ambiciet sa mundet me realizuar në bazë të buxhetit dhe e realizon. Rruga Bob-Doganaj është rrugë shumë kryesore, në vitin vijues do të mundohemi me futur në top prioritet për rehabilitim, mendojmë se e fitojmë grantin e performancës dhe i orientojmë mjetet ku ka më tepër frekuentim. Trotuari në Bajnicë, ka përfunduar deri ku ka shtëpi dhe qarkullim të njerëzve, dhe qarkullojnë njerëzit Duraj-Bajnicë, dhe nëse ka qarkullim, vazhdojmë në të ardhmen me projektin.

**z. Kemajl Jaha: Administrator i f. Stagovë:** Kërkoj të hynë në buxhet:

1. Vazhdimi i asfaltimit të rrugës Stagovë-Gërlicë. Nëse vazhdohet ky projekt, duhet me biseduar me italianë, ky është shqetësim i komunitetit, se nuk po lënë me vendosur rampë aty në dy anët për me kaluar. Kam biseduar një ditë me juve, duhet me marrë veprime në këtë drejtim, se mbesim pa rrugë. 2. Në shkollë vijnë qytetarët në 2-3 të natës me vetura. Për këtë çështje, se paku me i mbyllë dyert e shkollës, drejtori. Ne i kemi shtëpitë afër dhe na krijohet zhurmë se po vishkullojnë aty me vetura. Dyer ka, duhet të mbyllën, se neve po na krijojnë telashe, se i kemi shtëpitë afër, vijnë nga Hani i Elezit dhe vende tjera dhe ne na imponohet me i thirrur policinë.

**Kryetari i Komunës-Besim Ilazi:** Çështjen e rrugës, e kemi biseduar këtë çështje, brenda javës kemi me dalë në terren.

**z. Kadri Dardhishta: Administrator në Kaçanik:** I kam disa projekte, meqë disa janë realizuar, është bërë një punë e madhe, si rruga: “Kijani Bela”. E kam një kërkesë nga komuniteti, për emërtimin e rrugëve dhe parqeve të qytetit. Nuk e di a ju ka ardhur kërkesa?

**Kryesuesi i Kuvendit-Kemal Murseli:** Është i formuar një komision nga KK për emërtimin e rrugëve. Kërkesat të cilat vijnë në komunë, komisioni i shqyrton. Në KK nuk na kanë ardhur ende emërtimet, nuk e di a është marrë komisioni me ato kërkesa apo jo, obligim e kanë me u marrë për emërtimin e ndonjë rruge të paemërtuar apo ndryshim e emrit të ndonjë rruge. Duhet pasur kujdes të emërtimet, se kjo po shkon në mënyrë jo të duhur të disa, se ka kritere të përcaktuara për emërtime të rrugëve, ndërkaq dëshira ka për rrugë në emër të baballarëve apo të ngjashme. Duhet parasysh parasysh kriteret se Agjencioni kadastral nuk i pranon emërtimet në kundërshtim me kriteret.

**z. Kadri Dardhishta: Administrator në Kaçanik:** E kuptoj këto që po i potencon, por kur janë emërtuar rrugët me herrët në emër të baballarëve, kur të vjen puna të gjyshi im, kjo nuk pranohet, ndërkaq shtoj se ka do emra të njerëzve që meritojnë me i pasur emrat e tyre rrugët, ndërsa ka që nuk i meritojnë, se nuk kanë dhënë ndonjë kontribut. Unë i adresoj kërkesa për emërtimin e rrugëve dhe parqeve që i kanë kërkuar, ndërkaq a aprovohen apo jo, ajo është çështje tjetër. Kërkesë për ngritjen e kompensimeve për administratorët e lagjeve, fshatrave.

**Kryesuesi i Kuvendit-Kemal Murseli:** Aty ku nuk ka pasur probleme, janë pranuar ashtu, por aty ku kanë pasur probleme. Në emërtimin e rrugëve, kërkohet të jetë një biografi e personit që rruga e merr emrin e tij. Pasesër është takimi me ministritë dhe mundemi me ngritur këtë çështje me shikuar se çka po na thonë.

**z. Qamil Stagova: Drejtor i DUKMM:** Puna e komisionit, është e vërtetë se ka ngecur se ka shumë punë, komisioni është duke punuar, kërkesat e juaja i ka në shqyrtim, ndërsa se qysh vendosën, ajo është çështje tjetër. Komisioni ka pasur konsultime edhe me ministrinë, se ka probleme nganjëherë, ministria ua ka dhënë do udhëzime.

**Kryesuesi i Kuvendit-Kemal Murseli:** Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, e shpalli debatin e përfunduar në ora 12:14.

Procesmbajtës  
Makfite Malsiu

*Makfite Malsiu*



Kryesuesi i Kuvendit  
Kemal Murseli

*Kemal Murseli*



Kaçanik, 17.09.2024

Lista e Pjesëmarrjes në Diskutim Publik të organizuar nga Kryesuesi i Kuvendit në bashkëpunim me KPF, për temën: Propozim Buxheti i Komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2025 dhe vlerësimet 2026-2027

Nr. rend.	Emri dhe Mbiemri	Përfaqësimi	Nënshkrimi
1.	KADRIN DARDINI	AD. D. N. I. K.	ZUMA 71
2.	Fatmir Luta	IVAJË - Gajre	Shushaj
3.	NAZIFLOKA	KOTLINE	Shushaj
4.	Naser Museli	Adesoni Dogamejo	Shushaj
5.	FADIL RASHI	AD. DUBRAVË	Shushaj
6.	HASIP SAKHU	AD. M. BRONICË	Shushaj
7.	Adnan Krasnigi	P.D.M. K. UJETEN	Shushaj
8.	Zijadin Zenuni	NT "DURAJ TRANS"	Shushaj
9.	IBRAHIM DALLAS	F. SOPONCO	Shushaj
10.	Fitum Telmani	Dogamej (SHFMU "Ali Urdha")	Shushaj
11.	SHEPKU QURU	Drejtor Gj. "Skenderbeu"	Shushaj
12.	Zydrin Osari	SHFMU "Nora Osari"	Shushaj
13.	ARTANI GURU		Shushaj
14.	CLIRIM TRONI	Qytetar	Shushaj
15.	Fitore Vishi	Udhëheqëse për DBF	Shushaj
16.	Zydrin Osari	SHFMU "Nora Osari"	Shushaj
17.	Diana Reka	SHFMU "Emin Duraku"	Shushaj
18.	AZEM KORAÇI	Administratori F. R. K.	Shushaj
19.	Danusha Zej		Shushaj
20.	Bashkim Krasnigi	Drejtor i SHFMU	Shushaj
21.	PRANVERË LOKU ZHARÇI	DZHEK	Shushaj



22.	Sawadun Osman	D. S. P. A.	J. L. W.
23.	Mahjine Malsia	Zylta eLPKK	M. G. M.
24.	BESIH ILAH	KOMUNITA SEAGAR	B. J.
25.	Kemal Murseli	K. K. Kapanik	B. J.
26.	DAMIK STAGOURA	KOMUNITA KAP	W. M. Y.
27.	Fatime Guri	K. Kapanik	S. J.
28.	Dardana Dauti	K. Kapanik	B. J.
29.	Sali Malsia	K. Kapanik	B. J.
30.	Kemal Murseli	F. Stogouris	B. J.
31.	BAHRISALIMI	D. F. B.	B. J.
32.	(31)		
33.			
34.			
35.			
36.			
37.			
38.			
39.			
40.			
41.			
42.			
43.			
44.			
45.			





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kacanik  
Municipal Kacanik  
Kryesuesi i Kuvendit  
01.Nr.60/ 21329 /24  
Kaçanik 02.09.2024

### FTESE PËR DISKUTIM PUBLIK

Të nderuar qytetarë të Komunës së Kaçanikut,

Në bashkëpunim me Komitetin për Politikë dhe Financa, në pajtim me rregullat ligjore, kam organizuar Diskutim Publik me qytetarët e komunës së Kaçanikut, OJQ dhe Grupe tjera të interesit.

Diskutimi publik do të mbahet me 17 shtator 2024 (e Martë ) në ora 11:00.

Vendi: Salla e kuvendit, kati i tretë (3).

**Tema:** Propozim Buxheti i Komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2025 dhe vlerësimet për vitet: 2026-2027.

Në Diskutim publik, të pranishëm do të jenë: Kryesuesi i Kuvendit, Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, Kryetari i Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive Komunale.

Propozim Buxheti do të publikohet në Faqen Zyrtare të Komunës në adresen: <http://kk.rks-gov.net/kaçanik/> dhe në Facebook të Komunës.

Qytetarë të nderuar, OJQ dhe Grupe tjera të interesit, Bëhuni pjesë e Diskutimit Publik, që të jeni pjesë e planifikimin buxhetor të vitit fiskal 2025 dhe vleresimeve per vitet: 2026-2027.

Me respekt!

Kryesuesi i Kuvendit  
Kemal Murseli